

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

---

**Informacione te pergjitheshme**

Shoqeria "VELLAZERIA "shpk është krijuar me vendim të Gjykatës së shkallës Parë Tirane nr.13043 date 11.12.1995.

Forma ligjore e shoqërisë është. Sh.P.K.

Vlera e kapitalit të shoqërisë është 222 500 000 leke e ndare në 100 aksione ose pjesë.

Shoqëria "VELLAZERIA" ka dy pronarë që zoterojnë respektivisht 67% dhe 33% të kontributit në kapital.

Veprimtaria kryesore tregtare e sajë është e përcaktuar hollësisht në vendimin e gjykatës të krijimit të saj si dhe në statut.

Aktualisht ajo merret me ndertime të ndryshme dhe prodhim materjale ndertimi e tjera.

Selia qendrore e Shoqërisë është në Krum të Kukësit .

Ajo ka seli edhe në Tiranë në Kompleksin Karl Topia kll2.kati 2.

Nipti i saj është J764189011.

**Permbledhje e politikave kontabel**

**Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elementetë metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

*Ne paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2019 është zbatuar formati i SKK-2.1e permirsuar.*

**Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur , janë si më poshtë:**

**Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e



skontimeve ose rabatat e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

### **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin perfaqson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin është 15 % dhe nuk ka ndryshim me ushtrimin e mëparshëm.

### **Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### **Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### **Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabel e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabel e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e



perdorura jane ne ndertesa 5 % te vleres mbetur dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

### Gjendjet e inventaret

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

#### Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2017 jane si me poshte:

A	AKTIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
1	Aktivemonetare	512,531	12,505,111	3,860,595

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.

Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes se Shqiperise.

### INVESTIME

Shoqeria nuk ka kryer investime afatshkurtra.

#### **Të drejta të arkëtueshme.**

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 deklarohen si vijon:

A	AKTIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
	<b>Të drejtat të arkëtueshme</b>		90,594,752	111,592,725
1	<i>Nga aktiviteti ishfrtëzimit</i>	411	90,594,752	111,592,725
2	<i>Nga njësitë ekonomike brendagrupit</i>		-	-
3	<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesapjesëmarrëse</i>	4614	-	-
4	<i>Të tjera</i>	413	-	-
5	<i>Kapitali nënshkruar i papaguar</i>	447	-	-
6	<i>Te tjera ,tatim mbi vlerene shtuar tvsh</i>	445	471,310	-

Ne "Llogari /Nga aktiviteti ishfrtëzimit jane pasqyruar kerkesat ndaj klienteve per shitjen e mallrave dhe sherbimeve .Lista e tyre analitike i bashkangjitet pasqyrave financiare.



Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Kerkesat ndaj klienteve ne monedhe te huaj jan vlersuar me kursin e bankes se Shqiperise te dates 31.12.2019.

## Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqitet si vijon.

Vlersimi i stokut eshte bere sipas standartit .(skk nr 4)

Shoqeria ka bere inventarin fizik te mallrave dhe te produktit te gatshem dhe disponon listat e inventarve .

A	AKTIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
	<b>Inventarët</b>		<b>25,780,992</b>	<b>19,522,482</b>
1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	311; 312;	7,061,195	802,685
2	Prodhimenëprocesdhegjysëmprodukte			
3	Produktetëgatshme	342	18,719,797	18,719,797
4	Mallra	375	-	-
5	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e mejmëri)			
6	Parapagimepërinventar		-	-
7	AAGJM tëmbajturapërshitje			

**Shpenzime të shtyra nuk ka.**

**Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara nuk ka.**

## Aktivët Afatgjatë (Investime financiare afatgjatë)

A	AKTIVET	Ref. llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
1	<b>Aktive financiare</b>		<b>46,004,929</b>	<b>48,990,359</b>
1	Titujpronësi nënjësitë ekonomike brendagrupit		0	0
2	Titujtëhuadhënies nënjësitë ekonomike brendagrupit		0	0
3	Titujpronësi nënjësitë ekonomike kukainteresapjesëmarrëse		0	0
4	Titujtëhuadhënies nënjësitë ekonomike kukainteresapjesëmarrë		0	0
5	Titujtëjtjerëtëmbajtur si aktive afatgjatë	519	1,771,000	1,771,000
6	Titujtëjtjerëtëhuadhënies fpp	460	11,281,780	11,281,780
7	Investuarortakette FPP	268	20,076,085	20,076,085



8	Titujt tjeret e huadhënies, ortakët	455	12,876,064	15,861,494
---	-------------------------------------	-----	------------	------------

Ne Titujt tjeret e mbajtur si aktive afatgjata ne vleren 1,771,000 leke jane pasqyruar garacite bankare te vena per lejet e shfrytezimit minerare ne momentin e marjes se tyre (ketu jane perfshire edhe garancite e vena per lejet e shfrytzimit te trasferuara te shoqeria Vellazeria Minerals Albania ,te cilat ne momentin e çbllokimit duhet te kalojne ne llogarine bankare te shoqerise Vellazeria shpk.

Ne Titujt tjeret e huadhënies (FPP) jane pasqyruar detyrimet qe ka Fabrika e Pasurimit Kromit Perollaj per borxhet ende te pa shlyera.

Ne Investimet e ortakëve ne kapitalin e fabrikes Paurimit Kromit eshte pasqyruar kontributi i ortakëve qe kane qene pronare ose ortakte shoqeria Vellazeria shpk ne momentin e dhenies se ketij kontributi.

Ne detyrime te tjera huadhenie jane pasqyruar detyrimet e ortakut qe ka ndaj shoqerise ne fund te vitit ushtrimore 2019.

Shumat respective te detyrimeve jane te detajuara ne llogarite analitike.

### **Aktivet Afatgjata Materiale (AAM-te)**

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet :

A	AKTIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
2	Aktive afatgjata materiale		48,331,382	39,224,124
(i)	Tokadhendërtesa	211-212	24,049,611	16,082,561
(ii)	Impiantedhemakineri	213-215	15,764,481	14,685,093
(iii)	Të tjera instalime dhe pajisje	218	1,762,581	1,701,761
(iv)	aktive materiale në proces (karjer shfrytzimi)	2114	6,754,710	6,754,710

Ne aktivet afat gjata materjale jane pasqyruar toka, ndertesat , makineri paisje ,mjetet e transportit dhe pajisjet e zyles dhe investimet e bera ne karjerat e shfrytzimit.

Shtesat dhe paksimet jane pasqyruar sakte.

Vlersimi i tyre eshte bere me vleren neto kontabel.

Grupimi dhe vlersimi tyre eshte bere i sakte.

Amortizim eshte llogaritur brenda normave te lejuara.

**Aktive biologjike afat gjata nuk ka.**

**Aktive Afat gjata jo materjale nuk ka.**

**Kapitali aksionar I pa paguar : ketu eshte pasqyruar pjesa e kapitalit e pa paguar e ortakut qe ka blere 34% te kuota te ortakut te larguar ne fund te vitit ushtrimore 2016 dhe 33% te kuotave te ortakut tjeter te larguar qe u blene dhe u shkembyen nga ortaku i ardhur nga shoqeria Start 2006 shpk. Ky kontribut do te derdhet ne shoqeri nga ortakët perfituse.**



**Ortakët që u larguan për diferencën e detyrimit të pa mbuluar me detyrimet që kishte në shoqëri do të paguhet nga shoqëria sipas marrëveshjeve të bera.**

**Aktive tatimore të shtyra nuk ka.**

**Detyrime afatshkurtera**

B	PASIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
	<b>Detyrimeafatshkurtra:</b>		63,556,339	63,556,339
1	Titujt e huamarrjes	4612	-	-
2	Detyrimendajinstitucionevetëkredisë	460 ; 461	0	0
3	Arkëtimenëavancëpërporosi	409	0	0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	401,418	58,006,547	58,006,547
5	Dëftesatëpagueshme		0	0
6	Tëpagueshmendajnjësiveekonomikebrendagrupit		0	0
7	Tëpagueshmendajnjësiveekonomikekukainteressapjesëmarrëse		-	-
8	Tëpagueshmendajpunonjësvedhesigurimeveshoqërore/shëndetsore	421,431	3,727,425	3,727,425
9	Tëpagueshmemepërdetyrimettatimore	444,442,449	75,660	75,660
10	Te tjera shteti tvsh		1,746,705	1,746,705

Drejtimi mendon se të gjitha detyrimet huat dhe parapagimet do të paguheshin në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënje në vlerë.

Detyrimet në monedhë të huaj janë vlersuar me kursin e bankës së Shqipërisë të datës 31.12.2019.

*Ne Detyrime ndaj institucioneve të kredisë janë pasqyruar detyrime ndaj bankave për kredite e mara para vitit ushtrimore.*

*Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit pasqyrojnë detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit si parapagimet e mara gjatë vitit ushtrimore të cilat kanë lidhje me aktivitetin e shfrytëzimit.*

Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shumën e llogarive sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor.

Vlersimi është bërë faturë për faturë të mbetur e pa u likuiduar.

Drejtimi mendon se të drejtat e furnitorëve janë të vlersuara realisht.

“Të pagueshme ndaj punonjësve” përbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit si detyrimet për sigurimet shoqërore .

“Detyrimet tatimore përfaqësojnë detyrimin për ,tatimin mbi page e tatim fitimi e tjera.

**Provizione afatshkurtra nuk ka.**

**Te pagueshme për shpenzime të konstatuara nuk ka**

**Të pagueshme për shpenzime të konstatuara**

Detyrime Afatgjata është pasqyruar detyrimi ndaj ortakëve që u larguan ose shiti kapitalin e cila nuk u mbyllën me transferimin një pjese të aktivitetit apo me këmblimin e kuotave në kapital që u bënë në shoqëritë e ortakëve të larguar. Keto diferencë do të likuidohen sipas marrëveshjeve të bera ndërmjet palëve respektive.



## 18. KAPITALI

### .Kapitalet e veta.

Kapitalet e veta te shoqeris jane te barabarta me fitimet neto te realizuara ne vite plus kontributin fillestar.

B	PASIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
III	<b>KAPITALI</b>			
1	Aksionet e pakicës (përdoret vetëmnë pasqyrat financiare të konsoliduara)		-	-
2	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë (përdoret vetëmnë PF të konsoliduara)			
3	Kapitali i regjistruar (aksionar)	101	222,500,000	222,500,000
4	Primi i aksionit			
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)			
6	Rezervat statutor			
7	Rezervat ligjore	1071	2,169,198	2,169,198
8	Rezervat tjera			
9	Fitimet (humbja) e pashpërdara	108	8,923,409	8,923,409
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	109	902,456	3,245,033
	<b>TOTALI I KAPITALIT (III)</b>	<b>18</b>	<b>234,495,063</b>	<b>236,837,640</b>

Gjate ushtrimit kontabel 2019 eshte realizuar nje fitim prej 902,456 leke.

## Pasqyra e Performancës

### 19. Fitimi (humbja) e vitit financiar

#### ▪ Te ardhurat .

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr.llog.	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
▶	Të ardhuranga aktiviteti i shfrytëzimit	701,705	37,285,097	114,196,553
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimin në proces	713-714	-	-
▶	Puna e kryer nga njësi ekonomike dhe e kapitalizuar			
▶	Të ardhurat të tjerat të shfrytëzimit	702,708	0	2010
	<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>37,285,097</b>	<b>114,198,563</b>



Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe e shërbimeve të ndërtimit janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zveshura nga TVSH-ja.

Ndryshimi i gjendjes së produktit gatshëm është pasqyruar, vlerësimi i tij është bërë sipas standarteve.

Njohja dhe vlerësimi janë bazuar në SNK-9.

#### **Shpenzimet e veprimtarisë kryesore.**

- Paraqitja në pasqyrat financiare është bërë sipas natyrës së tyre.

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr. llog.	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
1	Materialet konsumuara, mallrat dhe shërb.	501-608	(24,978,797)	(86,385,038)
2	Kosto e punës	641-648	(9,277,204.0)	(10,098,362.0)
	Pagat e personelit	641	(7,917,023)	(8,605,166)
	Shpenz. e sigurimit shoqërorëdheshend.	644	(1,360,181)	(1,493,196)
3	Vlera e mbetur aktiveve të shitura	652	0	(1,106,594)
4	Amortizimet dhe zhvlerësimet	68...	(312,494)	(7,471,890)
5	Shpenzimet tjera	61-63	(1,502,782)	(1,046,119)
	<b>Totali shpenzimeve (shuma 1 - 5)</b>		<b>(36,071,277)</b>	<b>(106,108,003)</b>

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë rregjistruar me shumën e paguara ose të pagueshme.

Në shpenzimet e blerjes dhe në të ardhurat nga shitja janë pasqyruar edhe autofaturat që lidhen me prodhimin që është bërë nga vete shoqëria të produktit të gatshëm, i cili është gjendje në magazine.

Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

Taksat lokale e shpenzimet e tjera që lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit. Në postin shpenzime të tjera.

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare.**

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Ref. llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	767, 667	28,651	2,426
	Fitimet (humbjet) nga kurs i këmbimit shpz. finc	769, 669,628	(148,215)	(4,148,191)

#### **-Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin kontabël 2019 janë si vijon.





Nr.	Përshkrimi I Elementëve	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2019	Viti Paraardhës 31.12.2018
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	109	1,094,256	3,944,794
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)		184,409	720,282
1	Amortizimetejnormavefiskale		0	0
2	Shpezimeprirje e dhurimetejkufirittatimor			
3	Gjjoba,penalitet,e demshperblime	657	184,409	720,282
4	Provizioneqenuknjihen			
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	658		
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)			
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)		1,278,665	4,665,076
V	Shpenzimitatim fitimit-15%	694	191,800	699,761
VI	FITIMI (HUMBJA) NETO I USHTRIMIT(I-V)	121	902,456	3,245,033

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatusem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Shpenzimet e tatim fitimit per viti ushromore jane 15% e fitimit fiskale.

### **Transaksione te paleve te lidhura**

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jane kryer ne perputhje me formen ligjore te tyre , ne 31 Dhjetor 2019.

### **Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

### **Shifrat krahasuese**

*Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2019 eshte zbatuar formati i SKK-2, i cili zbatohet qe nga viti 2008 dhe per rrjedhim zerat e pasqyrave financiare te periudhes jane te krahasueshme.*

### ***Vijushmeria e aktivitetit***

Mendoj qe vijushmeria e biznesit eshte e garantuar edhe per vitin ne vazhdim .

- *Ka emer te mire per sherbimet cilesore qe afron.*
- *Ka gjendje kesh dhe kerkesa per te arketuar per te perballuar detyrimet dhe per te investuar.*
- *Eshte korekte ne mardhenie me shtetin.*
- *Ka realizuar fitim .*

Tirane , me 25.03.2020

